



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 6, datë 29.07.2024

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:20

Data e mbajtjes së mbledhjes : 29.07.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve. Na falni për vonesën për një problem teknik.

Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar ! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin korrik. Siç jeni vënë në dijeni për rendin e ditës nga Sekretaria e Këshillit nëpërmjet postës elektronike, në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Pika të rendit të ditës sot kemi 18, po kaloj në lexim.

Dorina Milja: Prit, do bëjmë prezencën.

Ani Dyrmishi: Po, më fal.

I jap fjalën sekretares të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Fillojmë.

Ardian Muka ... Prezentderi tek.... Florian Tahiri...Mungon

32 Këshilltarë në sallë .

V.O... Hyn me vonesë gjatë mbledhjes këshilltari Dorian Isaj. Gjithsej gjatë mbledhjes 33 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Sot në rend dite kemi 18 pika. Po kaloj në leximin e tyre.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN KORRIK 2024
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 190, DATË 22.12.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “MUJO ULQINAKU” PALLATI NR.72, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR.
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA "KRISTO SOTIRI" PALLATI NR.53, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 99, DATË 30.03.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 38, DATË 09.05.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA “HYSEN MYSHKETA”, PALLATI NR.27, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR.
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 10.08.2020 PËRSA I PËRKET Z. ADRIATIK GONI DHE NR. 32, DATË 26.03.2021 PËRSA I PËRKET Z. ALBERT CURRI, Z. VLASH CURRI, Z. ERNEST CURRI DHE Z. JUSTIN CURRI SI DHE PËRSA I PËRKET Z.BARDHYL META, Z.ARMAND META, Z.LUTFI META, Z.NJ.FLORA META

<p>Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 143, DATË 24.11.2022 TË KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS “PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L. 17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR. 1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR. 15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”</p>
<p>Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 75, DATË 28.06.2021 PËRSA I PËRKET Z. XHEVDET KACMOLI, ZNJ. VILMA KACMOLI DHE ZNJ. ORNELA KONDAKÇIU SI DHE NR. 107, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET Z. DEMIR DEMAJ</p>
<p>Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 2, 5, 6, SUKTH, MANËZ DHE ISHËM BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.</p>
<p>Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 68, DATË 17.03.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "TEODOR RUPI", PALLATI NR.32, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”.</p>
<p>Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 178, DATË 01.12.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "STEFAN DHIMA" PALLATI NR.8, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”.</p>
<p>Pika 12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E NJË SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 189, DATË 22.12.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “VRESHTAVE” PALLATI NR.8, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR.</p>
<p>Pika 13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NËNTËMBËDHJETË TË 14 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL</p>

Pika 14. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË DURRËS
Pika 15. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË APARATIT TË BASHKISË DURRËS
Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 13, DATË 04.02.2021 , NR. 48, DATË 14.04.2021, NR. 67, DATË 10.06.2021, NR. 117, DATË 30.09.2021 NR. 142, DATË 12.11.2021, NR 166, DATË 23.12.2021 , NR 87, DATË 26.07.2022, NR. 141, DATË 24.11.2022 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR
Pika 17. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DYMBËDHJETË PARAPRAKE TË 41 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
Pika 18. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VKB-NË NR. 475, DATË 23.12.2017 “PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË RI TË ADRESAVE TË BASHKISË DURRËS”, I NDRYSHUAR
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Ani Dyrmishi: Atëherë këto ishin 18 pikat e rendit të ditës .

Ka ndonjë koment?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 32 vota pro, miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 1**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit znj. Shemsi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale, Barazisë Gjinore, pasi shqyrtoi listat për muajin korrik për individët dhe familjet që do të marrin ndihmën ekonomike brenda fondit 6% dhe nga të ardhurat e bashkisë, e miratoi atë dhe ia paraqet këshillit për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Atëherë kush është pro?

Kundra? ...Nuk ka.

Abstenim? ... Nuk ka.

Dorina Milja : 33 se erdhi dhe Dorian Isaj.

Ani Dyrmishi: Atëhere, me 33 vota pro miratohet pika 1.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike znj.Periana Kotri.

Periana Kotri: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike pasi shqyroi pikën 2, vendosi ta kaloj për miratim në këshill.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj.Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje!

Komisioni është dakord ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 2, ka?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 2.

- Kalojmë **në pikën 3**. Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike znj. Periana Kotri.

Periana Kotri: Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike e diskutoi në komision pikën 3 dhe vendosi ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj.Feshti.

Marsida Feshti: Komisioni është dakord ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit!

Komenmte për pikën 3, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet.

- Kalojmë **në pikën 4**. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike.

Periana Kotri: Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, pasi shqyrtoi pikën 4 vendosi ta kaloj për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi: Faleminderit, znj.Feshti.

Marsida Feshti: Komisioni është dakord ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Komente ka për këtë pikë?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet dhe pika 4.

- Kalojmë **në pikën 5**. Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike znj. Kotri.

Periana Kotri: Gjithashtu dhe pika 5 u shqyrtua dhe vendosëm që të kaloj në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi: znj.Feshti.

Marsida Feshti: Gjithashtu dhe pika 5 ramë dakord të kalojmë në votim.

Ani Dyrmishi: Komente kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 5.

- Kalojmë **në pikën 6**. Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike znj. Kotri

Periana Kotri: Edhe pika 6 pasi u shqyrtua, u vendos të kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Znj.Feshti.

Marsida Feshti: Pika 6 është dakort që të të kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente, ka?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 6.

- Kalojmë **në pikën 7**. Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike znj. Kotri

Periana Kotri: Pika 7 u vendos të kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Znj.Feshti.

Marsida Feshti: Pika 7 u ra dakort që të kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 7, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 7.

- Kalojmë **në pikën 8**. znj. Kotri.

Periana Kotri: Pika 8 pasi u shqyrtua u vendos që të kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Zonja Feshti.

Marsida Feshti: Pika 8, komisioni është dakord që të kaloj për votim.

Ani Dyrmishi: Komente për pikën 8, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet.

- Kalojmë në projektvednimin për **pikën 9**. znj. Kotri.

Periana Kotri: Edhe për pikën 9 komisioni është dakord që të kaloj për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi: Zonja Feshti.

Marsida Feshti: Komisioni ka vendosur për pikën 9 që është dakord të kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Komente përsa i përket pikës 9, ka?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet.

- Kalojmë **në pikën 10.** znj. Kotri.

Periana Kotri: Edhe për pikën 10 komisioni e shqyrtoi vendosi ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Zonja Feshti.

Marsida Feshti: Pika 10 është dakord të kalohet për votim.

Ani Dyrmishi: Komente ?

Nuk ka.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet.

- Kalojmë në pikën 14, më falni **pika 11.** Zonja Kotri.

Periana Kotri: Edhe për pikën 11 komisioni e shqyrtoi dhe vendosi ta kaloj për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi: Zonja Feshti.

Marsida Feshti: Pika 11, komisioni është dakord të kalohet për votim.

Ani Dyrmishi: Komente përsa i përket pikës 11, kemi?

Nuk ka.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 11 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 12.** znj. Kotri.

Periana Kotri: Edhe për pikën 12 komisioni e shqyrtoi dhe ka vendosur ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Zonja Feshti.

Marsida Feshti: Pika 12, komisioni është dakord të kalohet në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 12, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet.

- Kalojmë **në pikën 13**. znj. Kotri.

Periana Kotri: Edhe pika 13, pasi u mor në shqyrtim, u vendos të kalohet për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi: Zonja Feshti.

Marsida Feshti: Pika 13, komisioni ka rënë dakord të kalohet për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 13, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 13 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 14**, z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Komisioni i Buxhetit, pikën 14, “Dokumenti i parë për projektbuxhetin afatmesëm 2025-2027” është dakor me pjesëmarrjen vetëm të anëtarëve të komisionit të Partisë Socialiste, vendosi ta kaloj në këshill dhe të miratohet.

Ani Dyrmishi: Komente për pikën 14, kemi?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Përsa i takon miratimit të projektdokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 të bashkisë Durrës dhe gjatë studimit që kemi bërë pra nga programi buxhetor dhe kalimit që bëmë në këshillin bashkiak, ne deklaruam votën kundër. Natyrisht jemi për zhvillim e qytetit, jemi për shtim në buxhet, por për mënyrën se si është servitur dhe se si do

shkojnë shpenzimet dhe investimet për qytetin e Durrësit propozuar nga ana e bashkisë dhe taksat, për mbledhjen radhës që ne kemi bërë, deklarojmë votën kundër. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Atëherë komente të tjera?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 14?

Kundra....

Abstenim.....

Dorina Milja : 23 pro, 9 kundër dhe 1 abstenim.

Ani Dyrmishi: *Me 23 pro, 9 kundra dhe 1 abstenim nuk kalon pika 14.*

- Kalojmë **në pikën 15**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Thjeshtë një ndërhyrje të vogël për pikën 14, për qytetarët, e kuptojmë sa të gatshëm janë dhe se sa i gatshëm është zoti, shoku Muka që qyteti të zhvillohet...

Ardian Muka : Zoti...

Rolant Xhelilaj: Ky është dokumenti i parë paraprak, që shkon tek njësit, që shkon tek qytetari për të marrë ato kërkesa që ata kanë për zhvillimin e projektbuxhetit afatmesëm 2025-2027, që brenda mund të futen shumë mirë dhe ato vërejtjet që ka zoti Muka më fal që i thashë shoku, në kuptimin miqësor dhe grupi përkatës, por jo të votosh kundër dokumentit paraprak, që shkon në të gjitha njësitë administrative për të marrë opinionin e parë, për të lidhur problemet që ka baza, që kanë qytetarët, që ka Durrësi. Kuptojmë dëshirën dhe gadishmërinë që kanë për zhvillimin e qytetit.

Për pikën 15, vëmëndja e qeverisë për mbylljen e procesit të legalizimit, është në këtë aspekt që ndikon ky projektvendim, i cili i shkruar kështu duket fare i thjeshtë, shtimi i numrit të punonjësve të aparatit të bashkisë Durrës, në të vërtetë është një masë e marrë nga qeveria, e cila do reflektohet dhe do implementohet në punën që do të bëjë bashkia në vazhdim për të lehtësuar vëmëndjen karshi qytetarëve, të cilët kanë probleme me legalizimin e shtëpijave të tyre, të cilat ato i kanë bërë me përpjekje për të rregulluar veten dhe familjet e tyre.

Komisioni unanimisht është dakord të kaloj dhe të votohet.

Ani Dyrmishi: Komente për pikën 15?

Po z.Muka.

Ardian Muka: Kam diçka për pikën 14. Megjithatë ne e thamë, ne jemi për të mirën e qytetit, ne jemi që buxheti të kaloj, sikurse ka kaluar. Për buxhetin afatmesëm 25-27, natyrisht që ne i kemi dhënë propozimet tona nëpër komisione dhe për fat të keq ato nuk janë marrë parasysh, për këtë fakt ne votuam kundra.

Përsa i takon pikës 15, do kërkonim nga ana e bashkisë, natyrisht të dëgjonim çfarë programi ka, kush do jenë detyrat, dhe çfarë funksioni do kryej kjo drejtori e re, që do propozohet. Natyrisht ne e kemi parasysh, por për ta dëgjuar dhe qytetarët. Pastaj do bëj komentet e mia përsa i përket kësaj pike. Faleminderit.

Gentian Kallmi: Përshëndetje! Faleminderit për pyetjen.

Atëherë projektvendimi me numër 15 i Njësisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve në Bashkinë Durrës rrjedh në respektim të VKM-së numër 435, datë 26.06.2024, “Për një shtesë në Vendimin nr. 867, datë 10.12.2014” të Këshillit të Ministrave. Në thelb disa nga detyrat funksionale që do kryej Njësia Koordinimi të Procesit të Legalizimeve janë : “po i citoj, i keni të përfshira dhe në relacionet me të cilin jeni njoftuar...”.

- Atëherë, të njoftoj subjektet që kanë aplikuar për legalizimin e ndërtimit pa leje në zonën me prioritet të zhvillimi urban dhe zonën informale të parkimit që të paraqesin kopjet të kërkesës për legalizim apo dokumentacion tjetër të nevojshëm për trajtimin me prioritet procesi,
- të administroj të dhëna dhe të plotësoj atë me informacione për të dhënat e objekteve, ndërtime pa leje dhe subjekte përkatëse sipas zonave, blloqeve përkatëse që do t'i nënshtrohen procesit duke i ndarë sipas kategorive përkatëse,
- të përcjell informacionin e gurbulluar dhe të konsoliduar në komision të evidentimit të subjekteve dhe të ndërtimit të objekteve pa leje të zonës së bllokut përkatës në ASHK,
- të veproj si ndërlidhësndërmjetës ndërmejt ASHK dhe komunitetit vendor të zonës përkatëse në lidhje me procesin e matjeve në terren, të objekteve të ndërtimit pa leje,
- të kontribuojë në ndëgjegjësimin e tij dhe të lehtësoj komunikimin dhe ndërveprimin e ndërsjelltë ndërmjet ASHK dhe subjekteve.

Normalisht ne kemi objektiv vitin 2026. Aktualisht për këtë 5 muaj ne mendojmë të bëjmë një shtesë strukture prej 20 personash duke parë vazhdimësinë e punës është një punë e re për ne, ky proces koordinimi me ASHK dhe me qënë se do jetë nevoja për të arrit nevojat për të arritur objektivat 2026 dhe mbase më herët do mund të lindi nevoja dhe një shtesë në vazhdim të numrit të punonjësve.

Ardian Muka : Cili ishte objektivi deri 2026?

Gentian Kallmi: Objekti 2026 për përfundimin e legalizimeve pa leje, e ndërtimeve pa leje.

Ani Dyrmishi: Faleminderit !

Koment tjetër ka?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Dhe siç e tha zoti Nënkyetar, pra mendohet që të mbarojë procesi i legalizimit në 2026, ndërkohë doja t'i kujtoja të gjithë bashkëqytetarëve të mi me këtë fjalë, besoj të gjithë shqiptarëve, premtimin e kryeministrit të dhënë në vitin 2013 që procesi i legalizimit do të përfundonte brenda mandatit të parë, pra flasim brenda vitit 2017. Flasim për 2026, pra 10 vite

më pas neve akoma diskutojmë për procesin e legalizimit. Një proces, i cili filloj duke pasur parasysh sensibilitetin që ka, flasim për vendimet pa leje në trojet e tyre ose jo, të qytetarëve durrsak ose shqiptarë, nga qeveria e djathtë, u krijua dhe një agjenci përkatëse që ishte Agjencia e Aliuzmit, pas Agjencisë Aluizmit, e cila kryu një punë të saj, po themi diskrete, nuk po themi se dhe vetë ministria me shumë problematika të ndeshura nuk arriti dot ta përmbyllte këtë proces. Para tre vitesh u bë bashkimi i zyrave, pra i Agjencisë së Aluizmit pranë Kadastrës. U deklarua që ky proces do tu përmbyllte për një periudhë 3 vjeçare ndërkohë që sot na kërkohet nëpërmjet VKM-së, na kërkohet këshillit bashkiak aprovimi i një drejtorie të re për të çuar këtë proces përpara akoma për dy vite të tjera. Ndërkohë që në deklarimet e kryeminsitrit kemi dëgjuar që ky proces do mbyllet brenda 2028. Pra aluizmi si agjenci, kadastrë, bashki tallet me qytetarët gjatë gjithë kësaj periudhe, dhe më e bukura ishte që ky procesi i legalizimit do u bënte gratis. Të gjithë jemi dëshmitarë që procesi jo vetëm që nuk ishte gratis, por u krye kundrejt pagesës, ku kryeshin pagesa të caktuar në vende përkatëse, por jo gratis.

Unë e shoh këtë si një proces që zhvillohet përpara fushatës elektorale të vitit 2025 dhe shërbimi i këtyre premtimi që jepet qytetarëve që brenda 2026 do përfundoj, është një premtim thjesht elektroral ku do kërkohen votat e radhës, ku do dalin e do thojnë me siguri që do jetë një proces që do të kryhet gratis pranë bashkisë. Dhe këtu do jemi që, uroj që jo, këtu do jemi që, do shohim që ky proces do vazhdoj me të njëjtat ritme siç ka vazhduar në vite. Për këto motive dhe për ato që thashë më sipër deklarojmë votën tonë kundër pikës së 15. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit!

Ndonjë koment tjetër?

Atëherë Arjeta Keci, Luan Nezha, pastaj Flutura.

Arjeta Keci: Atëherë afati i i punësimit të këtyre personave do të jetë 2 vjeçar, kur mbaron procesi?

Gentian Kallmi: E rëndësishme është fillimi i punës i kësaj drejtorie deri tek plotësimi i objektivave.

Ani Dyrmishi: Z. Nezha.

Luan Nezha: Po. Pse 20 vetë sië e keni deklaruar në raport? Edhe ASHK e Durrësit nuk besoj se ka më shumë se 4, 5-fishin e tij. Tjetër gjë, e-albania zyrat që do të ketë Durrësi ku do jetë ndasia, se të gjitha proceset e legalizimit bëhet me e-albania, tani qytetarët e Durrësit të zonave rurale do vinë të aplikojnë tek bashkia apo tek e-albania se njëra do ta sfidoj tjetrën. Faleminderit.

Gentian Kallmi: Atëhere mënyra e aplikimi nuk ndryshon. Ne kemi një rol për caktimin e prioritetëve dhe për ndjekjen e procedurave deri në finalizimin e tyre.

Luan Nezha: Po më fal, numri i punonjësve a nuk ju duket pak shumë? Se 20 punonjës, pothuajse sa një drejtori rajonale.

Gentian Kallmi: Bëhet fjalë për një proces pune të bashkisë numër 2 në vend, dhe nuk do jetë punë e rëndomtë.

Luan Nezha: Vota jonë është kundër.

Ani Dyrmishi: Znj. Kasa.

Flutura Kasa : Kryetar, këto të opozitës kanë të drejtë të flasin, prandaj kanë ardhur këtu, flasin sikur kanë ardhur nga hëna, por problemi është se këto 8 vjet e kanë pas zyrën e legalizimeve dhe s'kanë bo as 10% të legalizimeve.

Nuk them që s'ka vend për kritikë për kadastrën sot, ka sa të duash, por në momentin që ti je super i mbyt në këtë proces, them që nuk kanë arsye për me fol me gjuhë kritike. Nëse duan ta votojnë, ta votojnë, nëse s'duan, s'ka problem se kalon kështu siç është.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Ndonjë koment tjetër?

Rolant Xhelilaj: Me leje ?

Ani Dyrmishi: Po, z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Për merakun e zotit Muka, jemi në dy pozicione, po them kështu miqësisht të rehatshme. Ai ka detyra, të thotë që është premtim që s'mbahet. Ne kemi detyrën ta premtojmë e të punojmë, e të bëjmë me aq sa mundemi me atë katrahurë që na la peshqesh zotërit parafolës.

Për pjesën tjetër më vjen pak çudi me Luanin. Sa herë është diskutu në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, problem për të është legalizimi, vëmëndja e trajtimi i qytetarëve sipas preferencave politike, tashi ka merak, numrin e punonjësve që do punojnë tek bashkia se është içik tepër dhe thotë është vota ime kundër. Kjo është votë kundër qytetarit.

Kjo lloj ndërhyrjeje që po bën qeveria me një kalim detyre shtesë bashkisë është pikërisht për të ndihmuar qytetarët në vështirësitë që ato kanë patur, nga funksionim i institucioneve, të Kadastrës apo ASHK-së, që është dhe më sot, por mbi të gjitha është për qytetarët e Durrësit, bashkia duhet të jetë e vëmëndshme edhe tek ndërtimet pa leje në pronat e të tjerëve për ta ndihmuar me aq sa mundet si ndërmejtës, si këshillues, si ndihmës për plotësimin e saktë të dokumentave por dhe si ndjekës pranë sektorit kryesor qëndror për realizmin sidomos të zonave prioritare për zhvillimin e qytetit. Në këto kushte është një vendim që është në favor të qytetarit dhe Grupi i Partisë Socialiste e voton pro dhe ju bëjmë thirrje ta rishikojmë atë deklaratë pakuptim, se është deklaratë kundër qytetarëve, të atyre qytetarëve që kanë sjell të gjithëve ne që jemi këtu në Këshillin Bashkiak. Faleminderit!

Ani Dyrmishi: Tjetër? Po.

Ardian Muka: Më përmendi emrin, prandaj.

Nuk është e vërtetë atë që tha z.Xhelilaj, natyrisht e thashë se sensibiliteti qytetar ndaj gjithë procesit, të këtij problemi Partia Demokratike në pushtet e ka filluar si proces dhe ky natyrisht ishte një proces i ri, proces shumë funksional dhe duke pasur parasysh problematikat që u paraqiten, kërkoj kohën e vet. Unë e përsërita, nuk është menaxhuar mirë dhe në atë kohë, por unë ajo që iu referova, iu referova fjalës së kryeministrit socialist, i cili thotë që në mandatin e parë ne do mbarojmë procesin e legalizimeve, gjë që nuk është mbajtur as në mandatin e dytë dhe as në mandatin e tretë. Prandja kjo është një gënjeshtër që iu është bërë qytetarëve, natyrisht iu morën votat për të ardhur në pushtet, pjesa tjetër tregohet shumë qartë që ishte thjesht një premtim elektorale. Iu premtua gratis të gjithë qytetarëve, aty janë qytetarët, në qoftë se ngrihet dikush dhe thotë që këtë proces e kam bërë gratis, atëherë fajin e kam unë, procesi është bërë me pagesë.

Munir Konesha : Ju e bëtë 5 mijë euro, 5 mijë euro dhe i bëtë.....

Ardian Muka: Procesi është kryer me pagesë, pra kundrejt pagesës.

Llesh Çuni : Unë jam nja nga ata që jam marrë me procesin.

Munir Konesha : O z.Muka duhet të jeni korrekt duhet të jeni korrekt, tarifa e aplikimit është 0. Tarifa e tokës po, tarifa gratis...

Shumë zhurmë.....

Ani Dyrmishi: O znj. Musaraj, të lutem.

Erzen Laçi : Prapë me taksën e qytetarve paguan dhe 20 punonjës të tjerë dhe....

Ani Dyrmishi: Z. Laçi të lutem....

Z.Xhelilaj, po.

Rolant Xhelilaj: Atë gënjeshtërën e kryeministrit e nxjerr në shesh votimi edhe një mandat para edhe një mandat mbrapa dhe mandatin që vjen. Kështu që këtë merak le ta grumbullojnë atje, ky është merak për qytetarët durrsak, atë që kryeministri tha.... “që do e mbaroj në mandatin e parë”, dhe pa katrahurë dhe u detyrua të rishikojë pozicionet e qeverisë dhe njerëzit e përcaktuan me votë pëlqimin e tyre, dhe e treta dhe tashi bëri të katërtin. Në të katërtin bëhet fjalë për, t’i kalohet një detyrë për bashkinë e Durrësit, të ndihmojnë qytetarin në këtë proces të vështirë që edhe drejtorja, që s’po i përmend emrin që mos hymë në debate pa vlerë. Kjo është vetëm për qytetarin e Durrësit, për qytetarin e Durrësit ata janë kundër të mos firmoset, të mos jetë pjesë e shqetësimeve që ato kanë dhe e përpjekjeve që ato bëjnë që të legalizojnë patjetër shtëpinë ku jetojnë dhe zhvillojnë gjithë aktivitetin e tyre familjar, është qëndrimi i tyre dhe propozim i tyre për ta bërë, se unë mendoj që janë disa pika që janë më direkt në ndihmë të qytetarëve dhe nuk mund të votosh kundër pamvarësisht qëndrimeve politike.

Pastaj angazhime, tha kryeministri apo s'tha kryeminsitri është e drejtë e tyre, patjetër ka thënë nuk ka zbatuar e ka shtyrë dhe një vendim për ta rishikuar atë situatë është një pikë tjetër, kalimi i një detyre suplementare në bashkinë e Durrësit për të ndihmuar që ky proces të mbyllet brënda 4 viteve. Ne jemi për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Znj. Keçi.

Arjeta Keçi : Problematikat e këtij procesi, besojmë, i dimë të gjithë. Kështu që e keni pasur në dorë të na e hidhnit këtë propozim shumë më përpara dhe ta hidhnit për votim.

Ani Dyrmishi: z. Nezha?

Luan Nezha: Unë kam një pyetje për kolegun Xhelili.

230 mijë legalizime që zoti ministër Mazniku i tha janë ndërtuar mbas 2013-n apo para 2013-s?
Faleminderit .

Ani Dyrmishi: Ishte pyetje për Landin?

Luan Nezha: Jo meqë Landi.....

Joniada Musaraj : E do shqip tani. Më mirë që ka fillu puna, ju thoni mos punoni siç nuk kemi punu ne. Nuk shkon kështu.

Luan Nezha: Jo, më fal....

Shumë zhurmë.....

Joniada Musaraj : Edhe njëherë z.Muka e dëgjoj dhe respektoj për të gjitha pasaktësitë që i sheh natën e i thotë ditën.

Luan Nezha: Pyetjet e mia besoj kanë qënë koherente.

Ani Dyrmishi: Koment tjetër ka, përsa i përket kësaj pikës?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 15?

Numëro votat.

23 Pro

Kundra....9

Abstenim..... 1

Atëherë 23 pro, 9 kundra dhe 1 abstenim miratohet pika 15.

- Kalojmë **në pikën 16**. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike znj.Kotri.

Anisa Ibraj: U miratua apo jo

Ani Dyrmishi: U miratua

Anisa Ibraj: Po pse

Ani Dyrmishi: Është buxhet ajo tjetra.

Ça të themi ne tashi, rregulloren e ke dhe ti dhe unë përpara.

Anisa Ibraj: Duhet ta thuash pak me më të madhe që ta dëgjojmë dhe ne të tjerët.

Ani Dyrmishi: Kjo pjesë miratohet vazhdojmë me pjesët e tjera.

Periana Kotri : Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi u mbledh dhe e shqyrtoi pikën 16, vendosi ta kaloj për miratim.

Ani Dyrmishi: Znj. Feshti.

Marsida Feshti : Komisioni ra dakord të kaloj për votim.

Ani Dyrmishi: Komente për pikën 16, ka?

Po, z. Muka.

Ardian Muka: Një pyetje kisha aty. Janë disa familje të cila transferohen nga zona e Katundit të Ri pra në Spitallë, dhe kush është.....?

Ani Dyrmishi: Ja ta shpjegoj unë, se e njof atë zonën.

Ardian Muka: Jo, doja të pyesja diçka, domethënë transferimi i tyre ata janë shprehur se janë të kënaqur, pra janë spostuar nga territori i tyre. Flitet për godina të reja që ka ndërtuar qeveria për pjesën e të dëmtuarve nga tërmeti.

Ani Dyrmishi: Aty kanë qenë disa pallate, ka qenë një pallat nuk e e di nëse e ke idenë, ishe një pallat që u shemb, nuk mund të ndërtohet aty edhe do transferohen.

Adrian Muka: Pra diskutohet thjesht për pallatin, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Koment tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës?

Kundra?.....4

Abstenim?Nuk ka.

29 pro, 4 kundra atëhere miratohet pika 16.

- Kalojmë **në pikën 17**. znj.Kotri.

Periana Kotri : Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike shqyrtoi dhe pikën 17, vendosi ta kaloj për votim.

Ani Dyrmishi: Znj. Feshti.

Marsida Feshti : Komisioni ra dakord të kaloj për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 17, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 31 vota pro, 2 pa votuar miratohet.

- **Pika 18**. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj.Luarasi.

Denisa Luarasi: Përshëndetje Kryetar !

Edhe komisioni ynë ra dakort për miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës me venndodhje lagjja 13, njësia administrative nr.5, nga rruga “Demokracia”, në rrugën “Dëshmorët e Policisë”, sipas hartës bashkëngjitur, si dhe miratimin e ndryshimit të emërimit të rrugës me venndodhje lagjjen 8, njësia administrative nr.4, nga rruga “Oslo”, në rrugën “Gani Manushi”, sipas hartës bashkëngjitur.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 18, kemi?

Nuk ka. Kalojmë më votim.

Kush është pro?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 18 e rendit të ditës.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** vetëm z.Muka.

Ardian Muka: Zoti kryetar, ka lidhje me një Vendim nr.65, datë 24.05.2021 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 11’417’408,95 lekë me tvsh për familjet e dëmtuara si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar (demolim) e objekteve/ndërtesave apo mjete teknike (eskavator) nga IKMT dhe IMTV e Bashkisë Durrës, të klasifikuara si të pariparueshme sipas ekspertizës nga Instituti i Ndërtimit, në njësinë administrative nr. 5, dhe dërgimin e saj pranë Ministrisë së Rindërtimit për dhënien e fondit”, pra është një vendim i marrë nga këshilli

bashkiak. Natyrisht në rrugë formale, unë jam interesuar sesi funksionon, pra di që këto fonde panvarësisht që kalojnë nëpërmjet këshillit bashkiak dhe bashkisë së Durrësit, jepen dhe duhet të lëvrohen nga ana e Ministrisë së Brendshme nëpërmjet fondit të emergjencave civile, por nuk më duket normale që këto qytetarë të bien vërdallë pas tre vitesh, kur ne kalojmë në çdo mbledhje nga 10, 12, 15, fonde për pjesët e rindërtimit këto të mos trajtohen. Dhe kërkesa ime do ishte natyrisht të dali përgjegjësia e këshillit apo bashkisë aty ku nuk është vepruar dhe nga ana tjetër të ndërhyhet dhe të na raportohet në këshill për veprime që do të kryhen, derisa ky vendim i këshillit bashkiak të shkojë deri ne fund.

Doja një koment për këtë edhe nga ana e z.Zëvendëskryetar, faleminderit.

Gentian Kallmi: Atëherë referuar pyetjes suaj, ashu siç thatë edhe ju, ky vendim i këshillit bashkiak kalon në zbatim nëpërmjet fondeve të akorduara nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, janë fonde vjetore jo sipas kërkesave, në ndryshim nga programi i rindërtimit për të cilin ju miratoni pika janë fonde të miratuara të programit të rindërtimit. Aktualisht kemi një ngërc ligjor. Ngërci ligjor ka të bëjë me faktin që në momentin e mbajtjes së procesverbalit janë hartuar preventivat, por sipas legjislacionit në fuqi orenditë dhe punimet ndërtimore kanë një përqindje të caktuar jo të plotë në lidhje me rimbursimin e tyre, do ju informojmë edhe mbase mund të dalim shumë shpejt në mbledhjen e radhës me një korigjim dhe saktësim të këtij vendimi për tu ekzekutuar brenda vitit buxhetor.

Ardian Muka: Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Ju faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Socialiste

ROLANT XHELILAJ